

# POLITIKA E ANGAZHIMIT TE PRINDERVE TE MBARE DISTRIKTIT PER VITIN 2010

\* \* \* \* \*

## PJESA I. OBJEKTIVAT E PRITESHME

**DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** pranon zbatimin e kërkesave ligjore si më poshtë

- Drejtoria Arsimore do të realizojë programe, aktivitete dhe procedura për përfshirjen e prindërve/kujdestarëve në të gjitha shkollat e saj me programin Title I, Pjesa A, në përputhje me programet sipas paragrafit 1118 të Ligjit Arsimor të shkollave Filllore dhe 8-vjeçare (*më parë - ESEA-Elementary and Secondary Education Act*), të kapitullit 'Title I'<sup>1</sup>, Pjesa A e ligjit "Asnjë Fëmijë të mos Mbetet Mbrapa". Këto programe, aktivitete dhe procedura do të planifikohen dhe funksionojnë nëpërmjet një bashkëpunimi sa më të plotë me prindërit/kujdestarët pjesëmarrës.
- Drejtoria Arsimore do të bashkëpunojë me shkollat e saj për të siguruar që politikat e kërkuara në angazhimin e prindërve në nivel shkollë të jenë në pajtueshmëri me paragrafin 1118(b) të ESEA dhe që secila shkollë në zbatim të paragrafit 1118 (d) të ESEA, të përfshijë si komponent të saj një marrëveshje ndërmjet shkollës dhe prindërve.
- Drejtoria Arsimore dhe shkollat e saj, për ta bërë sa më të zbatueshme angazhimin e prindërve në bazë të 'Title I', Pjesa A, do të sigurojnë mundësi të shumta për pjesëmarrjen e prindërve të cilat kanë njohuri të kufizuara të Anglishtes, prindërve/kujdestarëve invalidë dhe prindërve/kujdestarëve të fëmijëve emigrantë në njohjen dhe kuptimin e informacionit shkollor, duke përfshirë dhënien e tyre në formate sa më të kuptueshme dhe uniforme dhe po të jetë nevoja edhe në gjuhën që ata flasin, kërkesë kjo e paragrafit 1111 të ESEA.
- Drejtoria Arsimore do të përfshijë prindërit/kujdestarët e fëmijëve të cilat kanë kontribuar në shkollat me fondin e programit 'Title I', Pjesa A, në marrjen e vendimeve, se si të shpenzohet 1 përqind e fondeve të Title I, Pjesa A të rezervuara për angazhimin e tyre dhe të sigurojë jo më pak se 95 përqind e kësaj shume të shkojë direkt në shkollat për aktivitete shkollë, siç është rënë dakort ndërmjet prindërve dhe administratës së shkollës.
- Drejtoria Arsimore udhëhiqet nga përkufizimi ligjor i mëposhtëm lidhur me angazhimin e prindërve dhe kërkon që shkollat, të cilat kanë përfituar nga fondi Title I të organizojnë programe, aktivitete dhe procedura në përputhje me këtë përkufizim:

*Përfshirje e prindërve do të thotë pjesëmarrje e prindërve/kujdestarëve në komunikim të rregullt, të dyanshëm dhe domethënë në proçesin mësimor dhe aktivitete të tjera shkollë dhe bërjen të sigurt që—*

<sup>1</sup> Title I-është program federal, pjesë nga ligji për arsimin 'Asnjë Fëmijë të mos Mbetet Mbrapa' (NCLB) i vitit 2001, për financimin e shkollave që kanë rezultate të ulta dhe që kanë nevojë për asistencë akademike në ndihmë të nxënësve të prapambetur, të familjeve me të ardhura të pakta, të nxënësve që kanë Anglishten gjuhë të dytë të tjera.

(A) prindërit/kujdestarët t'ë luajn një rol thelbësor në ndihmën e fëmijëve të tyre në mësim;

(B) prindërit/kujdestarët t'ë inkurajohen në angazhimin aktiv për edukimin e fëmijëve të tyre në shkollë;

(C) prindërit/kujdestarët t'ë jenë partnerët e mirëfilltë në edukimin e fëmijëve të tyre dhe t'ë përfshihen, në rastet e duhura, në marrjen e vendimeve si edhe në komitetet këshilluese për t'ë ndihmuar në procesin edukativ;

(D) t'ë realizojnë aktivitete të tjera, si ato t'ë përkrahura në paragrafin 1118 të ESEA.

## **PJESA II. MENYRAT SE SI DREJTORIA ARSIMORE DO TE ZBATOJE KOMPONENTET E POLITIKES SE PERFSHIRJES SE PRINDERVE TE MBARE DISTRIKTIT**

1. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të marrë masat e mëposhtme për pjesëmarrjen e prindërve/kujdestarëve në shtjellimin bashkërisht të planit të zgjerët të përfshirjes së tyre, sipas paragrafit 1112 të ESEA:

- Do të përfshijë Komitetin e Këshillimor të Prindërve (PAC)<sup>2</sup> të mbarë Drejtorisë të cili të merren me diskutimet e planit të Drejtorisë Arsimore mbi angazhimin e prindërve
- Do të ftojë të gjithë prindërit e Drejtorisë Arsimore përmes Programit (PREP), të Drejtorisë Arsimore 'Prindërit janë "R" Partnerë të Barabartë', të marrin pjesë në diskutimet e planit të Drejtorisë për përfshirjen e prindërve.

2. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të realizojë përfshirjen e prindërve/kujdestarëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të shkollës sipas paragrafit 1116 të ESEA:

- Do t'i dërgojë udhëzime, të firmosura nga Superintendenta e Përgjithëshme, Superintendente Rajonale dhe Drejtorëve të shkollave, çdo vit rreth datës 15 Shtator.
- Përfaqësuesit e programit 'Title I' do të bashkëpunojnë me kryetarët e prindërve dhe nëpunës të Zyrës së Angazhimit të Prindërve dhe Familjes, që të organizojnë sesione trainimi në nivel shkollë, rajoni dhe Drejtorie, mbi aspekte të ndryshme të programit 'Title I'.
- Shkollat do të zgjejnë rrugë për të rrethuar mendimet dhe firmave të prindërve nga personel që nuk është i Drejtorisë Arsimore rreth rreth Planit të Veprimit të Shkollës (dikur i quajtur Plani i Përmirësimit të Shkollës), Komitetet Këshillimore të Shkollave (SAC), janë mundësi për rritjen e pjesëmarrjes dhe përgjegjësisë të prindërve në Planin e Veprimit të Shkollës.
- Do të njoftojnë në kohën e duhur për mbledhjet ose anulimet e tyre nëpërmjet gazetës së shkollës, Shoqatave Shkollë-Familje, stendave të buletinit, dhe lajmeve në shtyp.
- Do të sigurojnë shërbime përkthimi për prindërit/kujdestarët, gjuha e parë të cilëve është një gjuhë tjetër nga Anglishtja, duke përfshirë nëse është e mundur, një përmblendje të

<sup>2</sup> Parent Advisory Committee

pikave kryesore të Planit të Veprimit të Shkollave, në 8 gjuhë kryesore të Drejtorisë më ndihmën e personelit, që ndodhet në këto rajone.

3. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të sigurojë bashkëpunimet e nevojshme të shpjeguara më poshtë, asistencë teknike dhe mbështetje të tjera për të ndihmuar shkollat që kanë përfituar nga fondi i 'Title I', Pjesa A, në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve efikase për angazhimin e prindërve në përmirësimin e arritjeve akademike të nxënësve dhe realizimin e objektivave të shkollës:

- Në bashkëpunim me Koordinatorin e Drejtorisë Arsimore dhe ata Rajonal të NCLB, Ombudsmenit rajonal dhe në bazë shkollë të Prindërve, Koordinatorin e Shkollës Komunitet, Këshillin Shkollës-Familje të Filadelfias (PHSC)<sup>3</sup>, Komitetin Këshillimor të Prindërve për Title I, Task Forcën "E Drejta për Arsimim në Filadelfia", grupin "Forca e Prindit" dhe grupe të tjera të prindërve, do të bëjë seminare në shkollë, për përfshirjen e prindërve në problemet e shkollës.
- Do të ofrojë kualifikime profesionale nga prindërit/kujdestarët për drejtorin e rinj dhe ekzistues të shkollave dhe për administratorin e tjetër, rreth mënyrave të angazhimit efektiv të prindërve dhe kujdestarëve.
- Do të kualifikojë stafin e ri dhe atë ekzistues, të cilët kanë detyra lidhur me angazhimin e prindërve (*p.sh.* Ombudsmenit e Prindërve, Koordinatorin e Shkollës-Komunitet, Mediatorin e Komunitetit<sup>4</sup>, Asistentin e Këshilltarit Dygjuhësh (*Bilingual counselor Assistants*) për të ndihmuar shkollat në përfshirjen sa më efektive të prindërve në problemet e shkollës.
- Do të japë ndihmë teknike me personel nga Zyra e Arsimit të Barabartë për të Gjithë, Zyra e Mbështetjes së Nxënësve me Shërbime të Veçanta<sup>6</sup>, Zyra e Angazhimit të Familjes, Komitetin dhe Organizatave me bazë besimi dhe stafin të zyrave rajonale të drejtorisë.
- Zyra e 'Title I' do të sigurojë asistencë teknike për shkollat dhe organizatat e prindërve, të tilla si Komiteti Këshillimor i Prindërve të 'Title I' (PAC), Shoqatat Shkollës-Familje, Task Forcën për të Drejtën e Arsimit të Filadelfias, Prindërit e Bashkuar të Arsimit Publik, Grupin Forcë e Prindit dhe ai Prindër-Komunitet.
- Do të realizojë zhvillimin e kualifikimeve profesionale duke koordinuar punën me Zyrën për Zhvillimin Arsimor.
- Do të realizojë seminare me prindërit në mbështetje të arritjeve të nxënësve dhe angazhimit të prindërve.
- Do të realizojë seminare për prindërit vullnetar mbi problemet e sigurisë në shkollë, prezencën e kulturave të ndryshme, zgjidhjen e konflikteve, shërbimet ndaj klientëve dhe tema të tjera, sipas kërkesave.
- Do të ofrojë trajnim dhe informacione të tjera për Komitetet Këshillimore të Shkollave (SACs). Prej Shtatorit 2010, çdo SAC do të programojë punën për zbatimin e Title I PREP me prindërit duke planifikuar trajnime me prindërit e shkollave të tyre.

<sup>3</sup> PHSC-Philadelphia Home and School Council

<sup>4</sup> Community Builders-Mediatorin e Komunitetit, koordinojnë punën për angazhimin e prindërve dhe komunitetin me problemet e shkollës

<sup>5</sup> Office of Educational Equity

<sup>6</sup> Office of School Support

- Zyrat Rajonale të PREP do të shërbejnë si këshilltarë për drejtorët dhe anëtarët e SAC për reflektimin në Buxhetet dhe Plan Veprimet e shkollave të nevojave të nxënësve dhe prindërve.
- Në përputhje me Përfytyro 2014, do të lehtësojnë bashkëpunimin e prindërve dhe familjeve me mësuesit dhe drejtorët.

4. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të ekoordinojë dhe harmonizojë strategjitë për angazhimin e prindërve sipas programit Title I, Pjesa A me strategjitë për angazhimin e prindërve në programet e tjera si mëposhtë: Head Start, Reading First, Early Reading First, Comprehensive Early Learning Centers, Bright Futures, Even Start, Parent Child Home dhe Cradle to Classroom, duke:

- Organizuar mbledhje tremujore ndërmjet Zyrës së Arsimit Parashkollor dhe Zyrës së Angazhimit të Prindërve, Familjes, Komunitetit dhe Organizatave me bazë besimi, e cila është përgjegjëse për përfshirjen e prindërve të mbarë Drejtorisë si p.sh. përfaqësues të prindërve nga programe dhe organizata të ndryshme. Sipas kërkesës, mund të vihet në dispozicion mbajtja me shkrim e informacionit mbi këto mbledhje.
- Organizuar sesione trainimi ose prezantime të përbashkëta për prindërit; para fillimit të vitit të ri shkollor; rreth tranzicionit të fëmijës nga parashkollor në kopsht dhe ndërhyrjet e suksesshme, që mund të bëhen në shtëpi nga prindi.
- Përfshirë grupe të prindërve nga programet e parashkollorëve në nisim të Programit 'Akademia e Prindërve' (PLA) për organizimin e seminareve për familjet, të cilat flasin në gjuhët tjetër nga Anglishtja.

5. **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** në bashkëpunim me prindërit/kujdestarët, do të marrë masat e mëposhtme për të bërë një vlerësim vjetor të përmbytjes dhe efektivitetit të politikës së përfshirjes së prindërve dhe gjithashtu vlerësimin e ndikimit të tyre në angazhimin e familjeve në shkollat e Title I. Vlerësimi do të përfshijë që nga identifikimi i pengesave, deri te pjesëmarrja e prindërve/kujdestarëve në aktivitetet prindërore (duke i kushtuar vëmendje të veçantë prindërve/kujdestarëve që janë në kushte të disfavorshme ekonomike, ata që janë invalidë që nuk flasin anglisht shumë mirë, me nivel të ulët arsimor, ose janë të ndonjërace ose pakice etnike). Drejtoria Arsimore në bazë të këtyre konkluzioneve do të krijojë strategji më efektive të gjithë përfshirjes së prindërve dhe do të rishikojë këto politika (me ndihmën e prindërve/kujdestarëve), nëse është e nevojshme.

Pikësynimi i Politikës së Përfshirjes së Prindërve është erritja e angazhimit të prindërve brenda Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Janë përcaktuar tre nënpika sipas kësaj synimi:

- a) tërheqja e mendimit të prindërve në politikën dhe procedurat e Drejtorisë Arsimore;
- b) shkolla dhe burimet e saj edukative dhe materiale të jenë sa më të hapura për prindërit;
- c) rritja e mundësive që prindërit të marrin sa më shumë informacion që të jetë e mundur, rreth arritjeve në mësim të fëmijëve të tyre, me burimet ndihmëse dhe mundësi të mbështetjes së shkollimit të tyre.

Në varësi të burimeve në dispozicion, Zyra e Studimeve dhe Vlerësimeve të Programit, ose një vlerësues i jashtëm, që funksionon direkt nën drejtimin e kësaj zyre, do të përdorë metodat e mëposhtme në vlerësimin e fazës së arritjes së synimit dhe në pikave: raporte vlerësimi (duke përfshirë Pyetsorin mbarë Rajonal të drejtuesve, mësuesve, prindërve, dhe nxënësve) grupet kryesisht me prindër, analizat e të dhënave, ashtu si edhe vëzhgimin e mbledhjeve dhe seminareve të trainimit.

**6. DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** do të mbështesë kapacitetin e shkollave dhe prindërve për një përfshirje më të madhe të tyre, me qëllim që të sigurojë përfshirje efektive të prindërve/kujdestarëve dhe të përkrahë bashkëpunimin e tyre me shkollën dhe komunitetin, për të përmirësuar arritjet akademike të nxënësve, nëpërmjet aktiviteteve të përshkruara si mëposhtë:

A. Drejtoria Arsimore me ndihmën e shkollave me programin Title I dhe zyrës së Mësimdhënies, zyrës së Dhënave Statistikore të Shkollave, Title I, dhe/ose zyrës Angazhimit të Prindërve, Familjes, Komunitetit dhe Organizatave me bazë besimi, dhe zyrës së Shërbimeve Mësimore të Specializuara do të sigurojë ndihmë sipas rastit, për prindër dhe kujdestarë të fëmijëve në shkollat e saj, që të kuptojnë temat e mëposhtme, duke marrë masat e përshkruara në këtë paragraf.

- standartet shtetërore të programit akademik;
- standartet shtetërore për arritjet akademike të nxënësve;
- vlerësimet/testet në provimet akademike të shtetit dhe ato lokale duke përfshirë vlerësimet alternative;
- kërkesat e programit Title I, Pjesa A të ligjit NCLB;
- Si të monitorojnë progresin e fëmijës së tyre dhe;
- Si të bashkëpunojnë me edukatorët.

- Zyra e Title I do të jetë e hapur në bashkëpunimin dhe koordinimin e punës me zyra të ndryshme dhe grupe prindërishe për organizimin e seminareve dhe prezantimeve rreth Title I sipas ligjit 'Asnjë Fëmijë të mos Mbetet Prapa'.
- Inkurajojë shkollat të ftojnë prindërit/kujdestarët në shkollë të vijojnë në ditë të kualifikimit profesional të mësuesve, kur të ketë diskutime rreth këtyre temave.
- Drejtorët e shkollave të fusin një komponent për diskutimin e problemeve lidhur me prindërit në ditë të planifikuara për kualifikimin profesional të këshillit pedagogjik
- Do të mbështesë pjesëmarrjen e prindërve në konferenca dhe seminare si p.sh. në Komitetin Këshillimor Shtetëror të Prindërve të Pensilvanisë, Konferencat Rajonale mbi Përfshirjen e Familjes në Shkollë, Konferenca e 32-të vjetore të Përfshirjes së Familjes në Shkollë (Koalicioni PA i Përfshirjes së Prindërve), Rrjeti Kombëtar i Shkollave në Partneritet, Konferenca e Shkollave më të Mira të Pensilvanisë, Konferenca e Trainimit të Prindërve për zgjerimin e Informacionit, organizuar nga Koordinatorët e Shoqatës së Pensilvanisë për programin federal dhe Programet Pedagogjike të Kualifikimit, bashkëpunim ky i Departamentit të Arsimit dhe Shkollave të larta.
- Do ju kërkohet prindërve/kujdestarëve, që do të marrin pjesë në konferenca dhe seminare të organizojnë trainime me prindërit e lagjeve të tyre rreth temave të trajtuara në këtë konferencë, ose të shkruajnë një raport si kusht për të siguruar sponsorizime.
- Do të sigurojë prindërve/kujdestarëve informacion në një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë.

- Do të organizojë seminare në gjuhën amtare për familjet të cilat e kanë anglishten gjuhë të dytë
- Do të shpërndajë materiale të Zyrës së Mësimdhënies dhe zyrave të tjera, duke përfshirë përkthime, kur është e përshtatshme, për prindërit dhe kujdestarët, të cilat do të jenë një referencë më të shprehshme dhe më të dobishme në shtëpi.

B. Drejtoria Arsimore, me ndihmën e shkollave të saj do të sigurojë materiale dhe trainime, në mënyrë që të ndihmojë prindërit dhe kujdestarët të punojnë me fëmijët për përmirësimin e tyre në mënyrë, si p.sh. trainime për leximin dhe duke përdorur teknologjinë e duhur të nënësipjesë marrjen e prindërve në rajonet duke:

- Vënë në jetë programin e “Universitetit të Prindit” në rajone, për ngritjen e nivelit të njohurive të prindërve, në të cilin do të përfshihet personeli i Drejtorisë Arsimore dhe të tjerë, për sa i përket mbështetjes së fëmijëve të tyre në shkollë dhe rritjes së njohurive mbi kompjuterin.
- Punuar me agjensi të ndryshme përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga: Zyra e Frekuentimit dhe Mungesave Paarsye, Qendra e Burimeve dhe Informacionit të Prindërve të PA (PIRC) dhe Këshillit Shtetëror të Prindërve të PA (SPAC), për të krijuar Qendrën e Informacionit të Prindërve në shkollat dhe Drejtorinë Arsimore.
- Siguruar trainime për të ndihmuar prindërit/kujdestarët si të kuptojnë dhe përdorin Rrjetin e Familjes (*FamilyNet*), si një nga mënyrat për monitorimin e arritjeve të fëmijëve të tyre.
- Inkurajuar shkollat (nëpërmjet Superintendenteve në Drejtori dhe ato Rajonale) të ftojë së paku dy prindër, një përfaqësues dhe një zëvendës, të marrin pjesë vullnetarisht në Programin e Drejtorisë Arsimore ‘Prindërit janë “R” Partnerë të Barabartë’. Drejtoria Arsimore do të bëjë kualifikime profesionale çdo tremujor mbi tema të Title I për të gjithë përfaqësuesit e këtij programi.
- Sugjeruar që prindërit e Title I PREP të shkollës, të ftohen për rishikim të Politikave të Përfshirjes të Prindërve sipas Title I dhe Bashkëpunimit Prindër-Shkollë. (sipas nevojave).
- Përdorur formularë të plotësuar nga takimet e PREP\_it, duke vazhduar me stafin rajonal (Ndihmës Superintendentet Rajonale ose të caktuarit e tyre), kur një shkollë nuk është përfaqësuar nga prindërit.
- Mbështetur përfshirjen e tre prindërve, nga çdo rajon në Komitetin e Këshillit të Prindërve të Title I të Drejtorisë Arsimore (“PAC”). Përfaqësuesit e PAC do të mbajnë mbledhje mujore në rajonet e tyre për përfaqësuesit e PREP të rajonit. Përfaqësuesit e PREP do të kryejnë trainime në shkollat e tyre.
- Mbështetur shkollat në planifikimin dhe kryerjen e aktiviteteve shkollore, si netat e shkrimit dhe këndimit dhe netat e matematikës për prindërit dhe seminare të tjera, që do të ndihmojnë prindërit/kujdestarët të kuptojnë se si të mbështesin arritjet akademike të fëmijëve të tyre me ndihmën e Zyrave Rajonale, të Mësimdhënies, të Shërbimeve të Specializuara dhe asaj të Zhvillimit të Mësimdhënies.
- Vënë në dispozicion personel të Drejtorisë Arsimore për të organizuar sesione trainimi dhe prezantimi për organizata si Këshilli Shkollë-Familje të Filadelfias, Shoqata Shkollë-Familje, Task Forca e Drejtës Arsimore të Filadelfias, Title I PAC dhe takime të tjera të prindërve, ose të organizatave të lagjeve.

- Siguruar materiale për seminarët e mësimërmësve në një gjuhë tjetër nga Anglishtja, kur është e mundur.
- Mbështesë në mënyrë të ngjashme me Komitetin Këshillimor të Shtetit të Pensilvanisë (SPAC), monitorimin e angazhimit të prindërve në shkollë nëpërmjet Zyrës Rajonale të Title I PREP dhe zhvillimin e mjeteve vlerësuese (me asistencë nga zyra përkatëse), për zbatim në çdo shkollë nga përfaqësuesit Rajonalë të PREP-it.
- Organizuar seminarët e mësimërmësve në mënyrë të përbashkët të lagjeve, përveç atyre të shkollës, si bibliotekat, organizatat e komunitetit dhe ato fetare, ku familjet mund të ndihen më komod.

C. Drejtoria Arsimore, me ndihmën e shkollave të saj dhe prindërve/kujdestarëve do të edukojë mësuesit, personelin që i shërben fëmijëve, drejtorët e shkollave dhe nëpunësit e tjerë si të afrojnë, komunikojnë dhe punojnë me prindërit/kujdestarët, si të zbatojnë dhe koordinojnë programet për prindërit dhe të ndërtojnë lidhje ndërmjet prindërve/kujdestarëve dhe shkollave, me anë të:

- Projektimit dhe zbatimit të një sërë seancash për ngritjen profesionale rreth temave të mësimërmësve.
- Përfshirjes së prindërve/kujdestarëve si trainues në seanca të bashkuara me administratorët, mësuesit dhe nëpunësit e tjerë të koordinuara këtu nëpërmjet zyrës së Mbështetjes Drejtuese e Mësimore, dhe të Zhvillimit të Mësimdhënies, dhe zyrës së Angazhimit të Prindërve, Familjes, Komunitetit dhe Organizatave me bazë besimi.
- Planifikimit të takimeve të rregullta midis zyrës së Mbështetjes Drejtuese e Mësimore, dhe të Zhvillimit të Mësimdhënies, Zyrës së Angazhimit të Prindërve, Familjes, Komunitetit dhe Organizatave të besimit, Zyrës së Shërbimeve Mësimore të Specializuara dhe përfaqësuesit të Komitetit Këshillimor të Prindërve të Title I.

D. Drejtoria Arsimore, maksimalisht do të koordinojë dhe integrojë programe për përfshirjen e prindërve bashkë me programet mësimore Head Start, Reading First, Comprehensive Early Learning Centers, Bright Futures, Even Start, Parent Child Home dhe Cradle to Classroom dhe programe të tjera, si edhe do të organizojnë aktivitete të tjera, p.sh. qëndra informacioni për prindërit që inkurajojnë dhe mbështesin prindërit/kujdestarët në pjesëmarrjen aktive për edukimin e fëmijëve të tyre, me anë të:

- Organizimit të takimeve tremujore brenda zyrës si çu përmend në pikën 4 më sipër.
- Përfshirjes së prindërve/kujdestarëve dhe personelit të programeve të mësimërmësve në aktivitete të Komitetit Këshillimor të Prindërve.
- Sigurimi i asistencës gjuhësore për nxënësit që mësojnë Anglisht (ELL), para-shkollorë dhe prindërit e tyre,

E. Drejtoria Arsimore do të marrë masat e mëposhtme për të siguruar, që informacioni lidhur me programet e shkollës dhe të prindërve, takimet dhe aktivitete të tjera t'i dërgohen prindërve/kujdestarëve të fëmijëve pjesëmarrës, në një format sa më të kuptueshëm, uniform dhe nëse është e realizueshme, në gjuhën që prindërit/kujdestarët mund ta kuptojnë.

- Sigurimi i komunikimeve në një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, nëse është e mundur, përveç rasteve kur ligji federal ose shteti e kërkon në një gjuhë tjetër.
- Pajisja me fjalor për të sqaruar shkurtime ose terma profesionale.
- Pajisja me materiale për njerëzit me shikim të kufizuar, p.sh. materiale me gërma të zmadhuara, sipas kërkesave.
- Sigurimi i përmblendhjeve dhe parathënieve të dokumenteve zyrtare.
- Sigurimi i versioneve dëgjimore ose video kasetave të dokumentave të përzgjedhura.
- Mundësia e sqarimeve me gojë të dokumentave të shkruara, nëse kjo kërkohet.
- Sigurimi i shërbimeve gjuhësore për familjet gjuha e parë të cilave është tjetër nga Anglishtja nëpërmjet shërbimeve me përkthim në shkollë ose me telefon, nëse është e përshtatshme.
- Shpërndarja gjërisht në të gjithë territorin e Drejtorisë të njoftimeve për prindërit dhe fëmijët rreth aktiviteteve kulturore dhe programeve të ndryshme.
- Publikimi në websaitin e Drejtorisë arsimore të komunikimeve të përmendura më lart.
- Vendosja e komunikimeve me prindërit duke vënë në përdorim sistemin e telefonit automatik (*auto-dialer*), linkun e Prindërve dhe websaitin e shkollës.
- Mbledhja në mënyrë sistematike e lajmërimeve dhe informacione lidhur me prindërit.
- Të kërkohet nga partnerët e komunitetit/lagjeve, duke përfshirë bibliotekat, qendrat e argëtimit, organizatat në bazë lagje dhe organizatat fetare që të ndihmojnë në përhapjen e informacionit.
- Nxjerrja, nëse është e përshtatshme e lajmërimeve në stacionin televiziv të Drejtorisë Arsimore, PS-TV dhe kanaleve të tjera publike, si edhe në radio.
- Nxjerrja, nëse është e përshtatshme e lajmërimeve në shtypin lokal, duke përfshirë këtu shtypin në gjuhë amtare, shtypin për reformën arsimore dhe gazetën e lagjeve.

### **PJESA III. PJESËMARRJA E PRINDERVE NË REFORMAT SHKOLLORE TË SHKOLLAVE QË KANË STATUSIN E SHKOLLAVE ME PROGRËS VJETOR TË PAMJAFTUESHËM OSE NË RISTRUKTURIM**

A. *Qëllimi.* Komisioni i Reformës së Shkollës është i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tij në zbatim të kërkesave të Aktit Federal të vitit 2001 ‘Asnjë Fëmijë të mos Mbetet Mbrapa’ (NCLB) në shkollat e Drejtorisë Arsimore, lidhur me pjesëmarrjen e prindërve në planifikimin dhe zbatimin e reformave, siç është përparshuar në pikën 20 U.S.C. § 6316 (b) (7) dhe (8) për shkollat që janë identifikuar me statusin në përmirësim dhe ristrukturim, sipas NCLB. Kjo politikë synon në njohjen e prindërve dhe të arsimtarëve me mundësitë për marrjen pjesë në zbatimin e këtyre reformave kyçe.

B. *Transferimi i Përgjegjësisë* Komisioni i Reformës Shkollore, duke i rezervuar rolin e vendimmarrjes ekipit të funksionarëve të lartë drejtues të drejtorisë edhe vetë Komisionit të Reformës Shkollore sipas Kodit të Shkollave Publike të Pensilvanisë, përfshirë këtu, por duke mos kufizuar pikën 24 P.S §§5-510, 6-693 dhe 6-696, paraqet drejtimet për:

1. Shkollat “në proces korrektues”

a. Drejtoria Arsimore do të botojë dhe dërgojë informacion në shkollat për sa i përket masave korrektuese që Drejtoria Arsimore merr, në bazë të tënë paragrafit 6316(b)(7) të NCLB

- (1) për publikun dhe prindërit e nxënësve, të cilët ndjekin shkollat me statusin në përmirësim ose në proces korrektues;
- (2) dhënia e informacionit në mënyrë të ekuivalente dhe uniforme në gjuhën që prindërit kuptojnë dhe
- (3) në përmjet mjeteve të informacionit si interneti, agjensive publike dhe medias duke përfshirë edhe websaitin e Drejtorisë Arsimore.

## 2. Shkollat në Ristrukturim

a. Drejtoria Arsimore do të

- (1) përgatisë një plan dhe do të bëjë ndryshimet e nevojshme për të zbatuar një ose më tepër nga mundësitë alternative të parashtruara në pikën 20 të U.S.C. § 6316 (b) (8)(B), nëse pas një viti shkollor të plotë në proces ristrukturimi dhe përmirësimi sipas pikës 20 U.S.C § 6316 (b) (7), një shkollë e cila është në veprimet korrektuese vazhdon të mos arrijë progres të mjaftueshëm vjetor;
- (2) njoftimi i mësuesve dhe prindërve sa herë që një shkollë bëhet subjekt ristrukturimi sipas tënë paragrafëve 6316(b)(8)(A) dhe (B); dhe
- (3) bëjnë të mundur që mësuesit dhe prindërit të
  - (a) paraqesin çdo vërejtje përpara marrjes së masave sipas tënë paragrafit 6316(b)(8)(A) dhe (B); dhe
  - (b) marrin pjesë në zhvillimin e planeve sipas tënë paragrafit 6316(b)(8)(A)(iii) (dhënies së alternativave të tjera mbi drejtimin e një shkolle).

## 3. Detyrat.

- a. Zyra e Drejtorisë Arsimore për Title I, ose zyra të tjera, që cakton zyra e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, në bashkëpunim me Zyrën e Komunikimit dhe atë të Kryetarit Akademik, duhet të japin informacionet e nevojshme për prindërit dhe do të organizojë, sponsorizojë dhe zbatojë procesin e pjesëmarrjes së prindërve siç kërkohet nga NCLB dhe politikës së përfshirjes së prindërve në problemet e shkollës.
- b. Sa herë që të jetë e mundur, Drejtoria Arsimore do të harmonizojë njoftimet, mbledhjet dhe kërkesat të tjera, sipas mandatit të NCLB dhe kësaj politike, me procedurat ekzistuese të pjesëmarrjes apo informimit të prindërve, që tashmë janë zbatuar në përputhje me NCLB, siç janë plani dhe politikat për përmirësimin e shkollave.
- c. Komunikimi me prindërit duhet të bëhet në përputhje me pikën 34 C.F.R § 200.36 me kusht që siç edhe është paraqitur në pikën 34 C.F.R § 200.36(c)(1), për shkak të rrethanave lokale, nëpunësit e Drejtorisë

Arsimore dhe shkollat mund të zgjedhin të japin informacion, përfshirë këtu njoftimet për t'ua shpërndarë prindërve.

4. Rezervimi i të drejtave.

- a. Vendimin përfundimtar në lidhje me shkollat me statusin e përmirësimit dhe ristrukturimit, në bazë të NCLB i takon Komisionit të Reformës Shkollore dhe Kodit të Shkollave Publike të Pensilvanisë, shiko, p.sh; 24 P.S. §§ 5-510, 6-693, 6-696. Në mënyrë që Drejtoria Arsimore të zbatojë misionin e saj sipas ligjit, ajo rezervon çdo të drejtë të saj për të gjitha çështjet e tjera të kësaj lloji.
- b. Megjithatë, Drejtoria Arsimore do të kërkojë edhe bërë të mundur, që prindërit të marrin pjesë siç parashtrohet nga NCLB në vendimet për ristrukturimin e shkollave të fëmijëve të tyre. Prindërit mund të marrin pjesë me anë të përfaqësuesve të tyre, duke përfshirë këtu grupet e komuniteteve dhe ato mbështetëse të tyre. Komisioni i Reformës Shkollore inkurajon të gjithë pjesëmarrësit nga çdo palë e interesuar, të cilët i janë përkushtuar punës për përmirësimin e çdo shkolle dhe e mirëpret bashkëpunimin me prindërit dhe me këdo të interesuar, në lidhje me këtë problem.
- c. Zbatimi i kësaj politike nuk do të mandatojë asnjë ndryshim kundrejt marrëveshjeve ekzistuese të kryera, ndaj të cilave Drejtoria Arsimore është palë pjesëmarrëse, por edhe as ndryshime të marrëveshjeve të tjera ku ajo është pjesëmarrëse, që nga Data e hyrjes në fuqi.

5. Përkufizimet.

- a. Përkufizimi i termit “Masat Korrektuese”<sup>7</sup> jepet qartë në pikën 20 U.S.C. § 6316(b)(7)(A)-(E) of NCLB
- b. Termi “Ristrukturim”<sup>8</sup> specifikohet në pikën 20 U.S.C § 6316(8), dhe “Alternativa të tjera në planin e përmirësimit të shkollës”<sup>9</sup> jepet në 20 U.S.C. § 6316(b)(8)(B)

**PJESA IV. THELLIMI I MASAVE TE POLITIKES SE PERFSHIRJES SE PRINDERVE TE MBARE DISTRIKTIT NGA DREJTORIA ARSIMORE**

- Të përfshihen prindërit/kujdestarët në ciklet e kualifikimeve të organizuara prej mësuesve, drejtorëve të shkollave dhe edukatorëve të tjerë për të rritur efektshmërinë e këtyre kualifikimeve;
- Të sigurohen kualifikime të nevojshme për programin Lexim dhe Këndim në Familje<sup>10</sup> nga fondet Title I të dhëna për programet “Even Start” dhe “Family Literacy”.
- Të bëhen shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme, sipas mundësive të buxhetit, për aktivitetet e prindërve, duke përfshirë transportin dhe pagesat për mbajtjen e

<sup>7</sup> Corrective Actions-Masat korrektuese, plani për përmirësim që i caktohet një shkollë e cila nuk ka arritur progresin adekuat vjetor (AYP)

<sup>8</sup> Restructuring-Ristrukturimi i shkollave që nuk kanë arritur AYP

<sup>9</sup> Alternative Governance-Ka të bëjë më gjetjen e rrugëve të tjera në lidhje me ato shkolla, të cilat akoma nuk arrijnë AYP

<sup>10</sup> Family Literacy-program për zhvillimin e Leximit dhe Këndimit në fëmijë të prindërve për leximin e librave me fëmijë të tyre

fëmijëve, që prindërit/kujdestarët të kenë mundësi të marrin pjesë në mbledhjet e shkollës dhe seancave të trajnimit;

- Të kualifikohen prindërit/kujdestarët për të rekrutuar prindërit/kujdestarët tjetër;
- Të caktohen takime shkollë në orë të ndryshme, ose të bëhen bashkëbisedime në shtëpi ndërmjet mësuesve dhe edukatorëve të tjerë që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët dhe prindërit/kujdestarët e të cilëve nuk kanë mundësi të marrin pjesë në takimet në shkollë;
- Të bëhen hulumtime, adoptime, dhe zbatime të metodave më të mira për përmirësimin e angazhimit të prindërve;
- Të krijohen grupet e prindërve këshilltarë, që të japin ndihmesën e tyre në të gjitha çështjet që lidhen me angazhimin e prindërve sipas programeve të Title I, Pjesa A;
- T'u jepet rëndësi organizatave në bazë lagje dhe bizneseve, duke përfshirë organizatat besimtare, në aktivitetet për angazhimin e prindërve; dhe
- Të sigurohen mbështetje të tjera të arsyeshme për aktivitetet e angazhimit të prindërve sipas paragrafit 1118, me kërkesë të prindërve/kujdestarëve.

#### **PJESA IV. MIRATIMI**

Politika e Angazhimit të Prindërve të Mbarë Distriktit është endërtuar dhe miratuar bashkë me prindërit/kujdestarët e fëmijëve, të cilët morën pjesë në programet e Title I, Pjesa A të ligjit 'Asnjë Fëmijë të mos Mbetet Mbrapa' (NCLB), në takimet e mbajtura në 19 Prill dhe 17 Maj të vitit 2010.

Kjo politikë u miratua nga **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS** më 22 Shtator 2010 dhe do të hyjë në fuqi për një vit akademik. Drejtoria Arsimore do të shpërndajë këtë material gjithë prindërve/kujdestarëve të fëmijëve pjesëmarrës në zbatim të programeve të Title I, Pjesa A deri më **30 Nëntor 2010**.

---

*(Signature of Authorized Official)*

---

*(Date)*

Referencat:

NCLB: 20 U.S.C. §§ 6316(b)(7), (8)  
C.F.R. 34 C.F.R. § 200.36  
State School Code: 24 P.S. § 1-101 *et seq.*, including 24 P.S. §§ 6-693, 6-696